



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
NJËSIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

Nr. 11484/prot.
2

Lezhë, më: 16.8.2023

PROJEKT-V E N D I M

Nr. _____, Datë _____, 2023

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFAQES SË FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË PARASHIKUARA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR PYJET.

Bazuar në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015" Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", VKM-në nr. 433 datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM-në nr 684 datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave e Bashkive", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, date 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", bazuar në kërkesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme për marrje toke pyjore në përdorim, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **2.5ha + 0.5km** rrugë auto ekzistuese, në parcelën pyjore **104** brenda Ekonomisë Pyjore "**Brinjat e Kreshtës**", Njësia Administrative Ungrej, sipas Raportit Teknik, bashkangjitur.
2. Afati për dhënie në përdorim do të jetë 10 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Vlera fillestare e qirasë në vit, përfshirë edhe infrastrukturën ndihmëse do të jetë **560000** (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lek.

4. Proçedura për dhënien në përdorim do të zhvillohet me garë të hapur sipas akteve ligjore e nën ligjore në fuqi.
5. Për zbatimin e proçedures pasi të kthehet në vendim, ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

KRYETARI

Pjerin NDREU

